

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Liqeni VII sh.a, është themeluar me vendimin nr 21244 date 29.04.1999 dhe është njëshoqëri aksionare. Objekti i saj kryesor është Ndertim dhe dhenie me Qira objektesh ne pronesi.

Gjatë vitit 1nuk ka pasur ndryshime në lidhje me madhësinë dhe me strukturën e zotërimit të kapitalit. Në datën e këtyre PF struktura e zotërimit te kapitalit paraqitet si vijon:

Ortaku	% në kapital	Numri i pjesëve		Vlera e kapitalit në ALL
		i	në	
Ramazan Kalia	99.96	54.847		54.847.000
Kujtim Deti	0.09	49		49.000
Arbentina Berzezi	0.06	33		33.000
Shpresa Deti	0.09	49		49.000
Totali	100	54.978		54.978.000

Administratori ligjor i shoqërisë është : Resilda Kalia, Musa Kalia

Selia juridike e Shoqërisë është: Lagja 14, Shkozet Durrës

Shoqëria është e regjistruar si person juridik ne Drejtorinë Rajonale Tatimore të Durrësit me NIPT K01730502W

Më 31 Dhjetor 2019 shoqëria ka 73 punonjës (31 Dhjetor 2018, 71 punonjës).

2. Parimet e përgatitjes se pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabël

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 25/2018 date 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet Kombëtare te Kontabilitetit (SKK) të përmirësuara të publikuara bazuar ne urdhrin e Ministrit të Financave nr 64 datë 22.07.2014 "Për Shpalljen e Standardeve Kontabël Kombëtare dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre"si dhe ne urdherin e Ministrit të Financave nr.28 date 30.01.2019 per shpalljen e disa ndryshimeve te SKK 2 dhe SKK 9.

(b) Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit te kostos historike.

Politikat kontabël janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK-ve të përmirësuara dhe të ligjit nr. 25/2018 date 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe paraqiten në shënimin vijes.

3. Politikat kontabël kryesore

Një përbledhje te pjesës me te madhe te politikave kontabël mbi bazën e te cilave janë përgatitur pasqyrat financiare janë paraqitur sa me poshtë:

3.1 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë MM ne dore dhe ato te mbajtura ne banka.

Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshin MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

(investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak) Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetarenuk përfshin investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershmë të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollet e këmbimit, etj).

Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korrespondojnë me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

3.2. Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogaritë e Arkëtueshme nga Klientët dhe në Kërkesa të tjera të Arkëtueshme. Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtar krijohet atëherë kur është evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient dhe kur një Llogari e Arkëtueshme vlerësohet që nuk mund të arkëtohet, ajo regjistrohet në shpenzimet dhe në Llogarinë e kërkesave të Arkëtueshme, duke e fshirë këtë të drejtë nga librat e saj kontabël. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë çregjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma.

Kërkesa te tjera të arkëtueshme njihen kur njësia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përvèç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtushme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

Një aktiv finanziar sipas përkufizimit të SKK 3 "Instrumentet financiare: Shënimet shpjeguese dhe Paraqitura" çregjistrohet pjesërisht ose totalisht (nuk paraqitet më në bilancin kontabël) në rastin kur Shoqëria parashikon që nuk do gjenerohen më flukse monetare nga ky aktiv dhe nuk ka më kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin.

3.3 Transaksionet me monedhat e huaja

a. Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

i) *Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes*

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia ("monedha funksionale"). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

b. Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj date. Diferencat nga konvertimi i klientëve apo furnitorëve, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin “Të tjera të ardhura (shpenzime) financiare”. Diferencat e kurseve të këmbimit të mjeteve monetare paraqiten në pasqyrën e të ardhurave në zërin e Fitiemve (humbjeve) nga kursi i këmbimit, në përputhje me kërkesat e SKK 12 “Efekti i Ndryshimit të kurseve të Këmbimit”.

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2019 janë:

Data / Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Euro	121.77	123.42
Usd	108.64	107.82
GBP	143	137.42

3.4 Inventarët

Inventarët nijhen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 Inventarët”, kur shoqëria i kontrollon apo zoteron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme. Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri. Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston e prodhimit të tyre (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti). Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën më të voglë midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes.

Shoqëria përdor metodën kontabël të inventarizimit të vazhduar dhe metodën e kostos mesatare/FIFO përmes matjen e inventarëve gjendje. Në datën e ndërtimit të PF shoqëria ka gjykuar që kosto e inventarit është më e ulët se vlera neto e realizueshme

3.5 Aktivet e Afatgjata Materiale dhe Jomateriale (AAM/AAJM)

(i) Njohja dhe vlerësimi

AAM dhe AAJM vlerësohen në hyrje me kosto historike. AAM paraqiten në Bilanc me koston e amortizuar (koston historike minus amortizimin e akumuluar minus zhvlerësimin nga ulja e vlerës (nëse ka). Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementeve. Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivit ose nijhen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundshme që ky element të sjellë hyrje të përftimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative. AAM paraqiten në bilanc me vlerën neto nga amortizimi

(ii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale llogaritet dhe nijhet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare. Ndërsa përmes gjithë zërat e tjerë amortizimi llogaritet dhe nijhet me metodën e vlerës së mbetur, me norma te cilat janë të përafërt me jetegjatesine mesatare te parashikuar te përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen.

Normat e amortizimit janë te paraqitura si me poshtë:

	<i>Norma Amortizimit</i> %	<i>Metoda Llogaritjes</i>
Ndërtesa	5%	Me Vleftën e mbetur
Makineri e pajisje	20%	Me Vleftën e mbetur
Mjete Transporti	20%	Me Vleftën e mbetur
Mobile Orendi	20%	Me Vleftën e mbetur
Pajisje Informatike	25%	Me Vleftën e mbetur

3.6 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave edhe shpenzimet e parapaguara.

3.7 Detyrimet

Shoqëria i klasifikon detyrimet në afatshkurtra dhe afatgjata.

Detyrimet afatshkurtra klasifikohen në Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe detyrime të tjera

Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Në detyrimet e tjera përfshihen detyrimet jotregtare dhe huamarrjet përvç llogarive të pagueshme dhe detyrimeve të tjera tregtare.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë paraqitur me shumën e tyre te llogaritur sipas kërkësave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare

Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huat më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferençë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabel.

Detyrimet afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar ame koston e amortizuar. Çdo diferençë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shoqëria nuk ka gjendje hua afatgjata në fund të periudhës raportuese.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat nga shitja e mallrave, produktive dhe shërbimeve njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimet e pronësisë së mallit apo produktit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri. Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtar ose jo.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar

parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

3.9 Shpenzime për personelin

(i) Kontributet për sigurime shoqërore dhe te ngashme

Shoqëria, gjate aktivitetit te saj normal, kryen pagesa ne emër te saj dhe te punonjësve te saj për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ne pajtim me legjislacionin ne fuqi. Kostot përkatëse te bëra ne emër te Shoqërisë ngarkohen ne pasqyrën e te ardhurave me ndodhjen e tyre.

(ii) Leje e zakonshme e paguar

Shoqëria i njeh si një shpenzim personeli dhe si detyrime ato kosto qe lidhen me lejen e zakonshme që u takon punonjësve për periudhën kur në fakt merret leja e zakonshme prej tyre.

3.10 Provizonet

Provizioni njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual qe ka lindur nga një ngjarje e shkuar, shlyerja e te cilit pritet te shoqërohet me dalje te burimeve dhe mund te behet një vlerësim relativisht i sakte i shumes se detyrimit.

3.11 Tatimi aktual mbi fitimin

Shoqëria nuk zbaton kërkeshat e SKK 11 për tatimin e shtyrë. Shoqëria për llogaritjen e tatimit aktual mbi të ardhurat bazohet në normën e tatimit që përcaktohet në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël.

Fitimi i tatushëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korrigjuar atë me shpenzimet e panjohura sipas përcaktimit të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat". Menaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimburueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon të paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

4. Mjetet monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e mjeteve monetare në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë. Një paraqitje e përbledhur e tyre jepet në tabelën vijuese:

	Viti 2019 Në lekë	Viti 2018 Në lekë
Mjete monetare në banke	763929	6649123
Mjete monetare në arkë	50584	
Totali	814513	7207261

Konvertimi i gjendjes në monedhë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2019 të shpallur nga Banka e Shqipërisë. Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në monedhë të huaj janë sistemuar në resultat.

4.1. Mjetet monetare në llogaritë bankare

Gjendja e llogarive bankare në fund të periudhës 2019 sipas monedhave paraqitet si vijon:

	Viti 2019 Në lekë	Viti 2018 Në lekë
Gjendje ne llogari bankare në lekë	29271	11751
Gjendje në llogari bankare në euro	648088	1605832
Gjendje në llogari bankare në dollarë	7461	7405
Gjendja e llogarise bankare ne paund	79109	5024134
Totali	763929	6649122

4.2 Mjetet monetare në arkë

Gjendja e likuiditeteve në arkë në vitin 2019 përbëhet nga shumat e mjetave monetare në monedhën kombëtare lek dhe në euro që ndodhen gjendje në shoqëri në 31.12.2019 në arkën qëndrore dhe arkat e tjera.

	Viti 2019 Në lekë	Viti 2018 Në lekë
Gjendje na arkë në lekë	50584	558138
Gjendje në arkë në Euro	0	0
Totali	50584	558138

5.Llogari Kërkesa të arkëtueshme

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientëve gjendje të paarkëtuar në 31 Dhjetor 2019. Një paraqitje e përbërjes së kërkesave të arkëtueshme ndaj klientëve jepet në tabelën vijuese:

Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	Viti 2019 Në lekë	Viti 2018 Në lekë
Kliente vendas	154257058	125592350
Kliente te huaj	0	0
Totali	154257058	125592350

6.Kërkesa të arkëtueshme të tjera

Një paraqitje e përbërjes së këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

	Viti 2019 Në lekë	Viti 2020 Në lekë
Kërkesa të arkëtueshme të tjera		
Parapagime të tretëve	995028	995028
Te drejta ndaj punonjesve	0	0
Te tjera kerkesa	26201239	7949322
Totali	27196267	8944350

Parapagimet të tretëve paraqet pagesat e bëra të tretëve për shërbimet që do të kryhen në të ardhmen prej tyre.

Të drejtat ndaj punonjësve paraqesin të drejtat ndaj personelit për paradhëniet e ndryshme të dhëna.

7. Inventarët

Shoqëria përdor disa lloje të inventarëve të nevojshëm për aktivitetin e vet. Shoqëria përdor metodën kontabël të inventarizimit te vazhdueshëm për evidentimin në kontabilitet të gjendjes dhe lëvizjes të inventarëve. Inventarët janë vlerësuar me kosto e cila është konsideruar nga drejtimi i shoqërisë si me e vogla e krahasuar me vlerën neto te realizueshme. Gjendja e inventarëve sipas llojeve të tyre paraqitet si vijon:

Inventari	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Lende te para	1856913	4208045
Produkte te gatshme	1500000	
Mallra per rishitje		
Totali	3365913	4208045

Gjendja e lëndëve të para përbëhet nga disa lloje të lëndëve të para dhe materialeve që përdoren në procesin e produkteve të shoqërisë. Një paraqitje e tyre më 31.12.2019 jepet në tabelën vijuese:

Lëndët e para	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Lëndët e para	1856913	4208045
Materiale amballazhi	0	
Inventar i imët	655789	684426
Totali	2512702	4892471

Produktet e gatshme përfshijnë vlefshen e produkteve te prodhua te cilat janë gjendje ne magazine. Në gjendjen e mallrave për rishitje përfshihet vlefta e mallrave te cilat blihen për ti rishitur

8. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Një paraqitje analitike e këtyre shpenzimeve jepet ne tabelën me poshtë:

Parapagine, shpenzime te shtyra	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Siguracione Kasko		
Shpenzime të periudhave të ardhme - Siguracione	299264	288125
Shpenzime të periudhave të ardhme- Mirëmbajtje		
Shpenzime të periudhave të ardhme - Të tjera		
Totali	299264	288125

Shpenzime te periudhave te ardhme-Siguracione-paraqet shumat e pashpërndara të primeve të sigurimit të paguara shoqërive të sigurimit për sigurimin e mjetetve te transportit dhe të aktiveve të shoqërisë.

Shpenzimet e periudhave te ardhme -Mirëmbajtje paraqesin shpenzimet e mirëmbajtjes së programeve informatike dhe që mbulojnë edhe vitin e ardhshëm.

9. Aktivet Afatgjata

Gjendja dhe shtesat e pakësimet e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe e amortizimeve të tyre gjatë vitit 2019 paraqiten si në tabelën vijuese:

Pasqyra e ndryshimit të AAM

	Toka, Ndertime	Makineri e pajisje pune	Automjete	Kompjutera dhe te ngjashme	Te tjera Aktive afatgjata	Aktive në biologjike	Total
Gjendja 31 Dhjetor 2017	118386774	39744633	14376554	1170209	3312964	700000	177691134
Blerjet gjatë viti ushtrimor		401661		5844	25878		433383
Shitet gjatë viti ushtrimor							
Nxjerrje jashte perdonimit							
Pakësime/Shtesa të tjera							
Riklasifikime		-149318					-149318
Gjendja 31 Dhjetor 2018	118386774	39996976	14376554	1176053	3338842	700000	177975199
Blerjet gjatë viti ushtrimor	109026	259854		69695			438575
Shitet gjatë viti ushtrimor							
Nxjerrje jashte perdonimit							
Pakësime/Shtesa të tjera							
Gjendja 31 Dhjetor 2019	118495800	40256830	14376554	1245748	3338842	700000	178413774

Pasqyra e ndryshimit të Amortizimit të AAM materiale

	Toka, Ndertime	Makineri e pajisje pune	Automjete	Kompjutera dhe te ngjashme	Te tjera Aktive afatgjata	Aktive biologjike	Total
Gjendja Më 31 Dhjetor 2017	59485293	18902000	5513874	726680	1453760	0	86081607
Amortizimi i periudhes ushtrimore	2612977	4168527	1772536	110882	371841	0	9036763
Amortizimi i AAGJM te shitura							
Amortizimi i AAGJM te Nxjerra jashte perdonimit							
Shtesa amortizimi nga riklasifikimi		-39138					
Gjendja Më 31 Dhjetor 2018	62098270	23031389	7286410	837562	1825601	0	95079232
Amortizimi i periudhes ushtrimore	2483238	3422474	1418028	94100	302648	0	7720488
Humbje nga Testi i vleres gjate periudhes							
Amortizimi i AAGJM te shitura							
Amortizimi i AAGJM te Nxjerra jashte perdonimit							
Shtesa amortizimi nga riklasifikimi							
Gjendja Më 31 Dhjetor 2019	64581508	26453863	8704438	931752	2128249	0	102799810

Në bilanc Aktivet Afatgjata paraqiten për çdo grup me vlerën neto pa amortizimin e akumuluar.

Llogaritja e amortizimit të AAM është bërë duke marre parasysh kohën e hyrjes së AAM. Normat e amortizimit të përdorura janë në përputhje me kërkesat e Ligjit 8438 date 28.12.1998, "Për Tatimin mbi te ardhurat".

9.1 Aktive të tjera Afatgjata jomateriale

Shoqeria nuk disponon aktive afatgjata jo materiale.

10. Detyrimet

Detyrimet e shoqërisë në bilanc paraqiten si vijon:

D E T Y R I M E	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
<i>Detyrime afatgjata</i>	12397637	16939238
<i>Detyrime afatshkurtra</i>	160335277	131846423
Totali	172732914	148785661

10.1 Detyrimet afatshkurtra

Paraqitja e detyrimeve afatshkurtra tregtare ne bilancin kontabël jepet si ne tabelën qe vijon:

Detyrimet afatshkurtra	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
<i>Të pagueshme ndaj furnitorëve</i>	74332440	49037655
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve</i>	4010228	2006569
<i>Detyrime tatimore</i>	300874	1618584
<i>Hua te Tjera</i>	81691762	79183615
Totali	160335277	131846423

10.2 Të pagueshme ndaj furnitorëve

Në këtë zë të bilancit paraqiten detyrimet ndaj furnitorëve ende të papaguara në fund të vitit 2019. Detyrimet në monedha të huaja janë konvertuar me kursin e datës së fundit të vitit publikuar nga Banka e Shqipërisë dhe diferencat janë sistemuar në rezultatin e periudhës. Një paraqitje analitike e këtyre detyrimeve jepet në tabelën vijuese:

<i>Të pagueshme ndaj furnitorëve</i>	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Furnitorë vendas	74332440	49037655
Furnitorë të huaj		
Furnitore per aktive A.Gjata		
Furnitore per fatura te pamberritura		
Totali	74332440	49037655

10.3 Të pagueshme ndaj punonjësve

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet ndaj punonjësve për pagat e llogaritura e të papaguara. Në vijim jepet paraqitja e tyre:

<i>Të pagueshme ndaj punonjësve</i>	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë

10.4 Detyrimet tatimore

Në këtë grup paraqiten detyrimet ndaj shtetit për Tatimet e taksat si dhe detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Një paraqitje e detajuar e këtyre detyrimeve jepet në vijim:

<i>Detyrime tatimore</i>	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Sigurime Shoqerore	592968	612230
Shteti - Tatim nga te ardhurat nga punesimi	150088	158209
Tatimi ne burim		-359375
Shteti- TVSh për tu paguar		357704
Tatimi mbi fitimin	150759	1462047
Totali	893815	2230815

Detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe për tatimin mbi pagat paraqesin shumat të llogaritura për pagat e punonjësve për muajin dhjetor 2019 të cilat janë paguar në janar të vitit 2020.

TVSH për tu paguar paraqet shumën e TVSH për tu paguar të llogaritur për muajin dhjetor 2019 e të paguar në muajin janar 2020.

Tatimi mbi fitmin paraqet shumën e detyrimit të llogaritur mbi fitmin faktik të tatueshëm për vitin 2019 dhe që paguhet branda datës 31 mars 2020.

10.5 Hua dhe detyrime të tjera

Në këtë zë paraqiten marrëdhëniet detyruese të shoqërisë me personelin e saj dhe të tjerë jo furnitorë. Gjatë vitit 2019 shoqëria i ka shlyer këto detyrime dhe nuk ka gjendje të pashlyera në fund të këtij vit raportues.

10.6 Detyrimet afatgjata

Në këtë zë të bilancit paraqiten shumat e kredive afatgjata që shoqëria ka marra nga Y. Përbërja analitike e tij paraqitet si më poshtë:

11. Kapitalet e veta

Gjendja e kapitaleve të veta më 31 dhjetor 2019, sipas zërave kryesorë të tyre të paraqitura në bilancin kontabël paraqitet si vijon:

Përbërja dhe ndryshimi i kapitaleve të veta gjatë vitit 2019 jepet në pasqyrën vijuese:

Kapitali aksionar	Rezerva statusore dhe ligjore	Fitimi i Pashpërndarë	Rezerva të tjera	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	54978090	204989	16738365	0
Rritja e kapitalit				
Zvogelim Fitimi per rezerva	126096			0
Tërheqje kapitali për zvogëlim				

Fitimi i periudhës kontabël			8998222		
Rezervim fitimi					9124318
Pozicioni më 31 dhjetor 2018	54978090	331085	25736587	0	81045762
Rritja e kapitalit					
Zvogelim Fitimi per rezerva		576008			
Tërheqje kapitali për zvogëlim					
Fitimi i periudhës kontabël			7945854		
Rezervim fitimi					8521862
Pozicioni më 31 dhjetor 2019	54978090	907093	33682441		89567624

12. Të ardhurat

Shoqëria i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet duke ndërtuar Pasqyrën e të ardhurave sipas natyrës.

12.1 Shitjet neto

Shoqëria realizon të ardhurat kryesore të aktivitetit të saj nga shitjet e produkteve të gatshëm, të mallrave për rishitje, të materialeve të ndryshme, etj. Në tabelën vijuese jepet një paraqitje e shitjeve neto:

Shitjet neto	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Shitjet neto Produkt i Gatsphem		
Shitjet neto Mallra Importi		
Shitjet neto Punime dhe Sherbime	223431412	158447825
Shitje materiale te para dhe ndihmese	551329	
Shitje te tjera	11940009	12804178
Totali i shitjeve neto	235922750	171252003

Shitjet janë paraqitur me vlerën neto nga kthimet e shitjeve.

12.2 Ndryshimi i gjendjes së produkteve të gatshme

Në këtë zë përfshihet efekti i ndryshimit të gjendjes së produkteve të gatshme në rezultatin e periudhës. Ky ndryshim i analizuar sipas produkteve paraqitet si vijon:

Ndryshimi i gjendjes se Produkteve të gatshme	Viti 2019	Viti 2018	Ndryshimi
	Në lekë	Në lekë	
Lende te para	1856913	4208045	2351132
Prodhimi ne proces			
Produkte te gatshme	1500000		-1500000
Totali	3356913	4208045	851132

12.3 Shpenzimet e lëndëve të para e materialeve të tjera

Përbërja e këtij zëri paraqitet në tabelën vijuese:

Materialet e konsumuara	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Shpenzimet e prodhimit të Produkteve të gatshme Blerje Materiale te para & Konsum Ambalazhimi Kosto e mallrave te shitur	35626663	34075489
Totali	<u>35626663</u>	<u>34075489</u>

12.4 Shpenzime personeli

Ne shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për pagat, shpërblime dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të llogaritura gjatë vitit 2019. Gjate vitit shoqëria ka llogaritur, dekluarar dhe paguar ne përputhje me kërkeshat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit. Një paraqitje e përbërjes së tyre jepet si vijon:

Kosto e punës	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
-Pagat e personelit	28261779	26961087
-Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	4240012	3975423
	<u>32501791</u>	<u>30936510</u>

Në nenzërin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore paraqiten shuma e kontributeve që llogarit dhe paguan shoqëria mbi fondin e pagave të punonjësve. Kontributet janë llogaritur në përputhje me tarifat dhe mënyrën e parashikuar nga ligji i kontributeve shoqërore e shëndetësore në fuqi gjatë vitit 2019.

12.5 Shpenzimet e amortizimeve dhe zhvlerësimet

Përbërja e këtyre shpenzimeve jepet në tabelën vijuese:

Amortizimi dhe zhvlerësimet	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Amortizimi i AAM	7720489	9036763
Totali	<u>7720489</u>	<u>9036763</u>

Shpenzimet e amortizimit janë llogaritur në përputhje me normat dhe metodat fiskale dhe duke marrë parasysh edhe kohën e hyrjes apo daljes së aktiveve afatgjata.

12.6 Shpenzimet e tjera

Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet e tjera të aktiviteti kryësor të shoqërisë. Përbërja e tyra jepet në tabelën në vijim:

Shpenzime të tjera	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
	Shpenzime Qeraje	0

Shpenzime Mirembajtje & Riparime	565792	1038699
Shpenzime Siguracione Automjete & Prone	544976	562118
Shpenzime te Ndryshme	2671833	3502875
Sherbime profesionale	100000	120000
Shpenzime Marketing & Promocionale		433532
Shpenzime Udhetime Dieta	565027	690674
Shpenzime Telefoni	309164	317036
Shpenzime Transporti	30417	6500
Shpenzime Bankare	812298	770309
Shpenzime taksa vendore, automjete	1003182	1104387
Shpenzime pritje, Gjoba, Penalitete, e të ngjashme	259849	6684659
Mallra te Demtuara/Skaduara /Skarco		
Shpenzime karburanti	29864630	25410408
Shpenzime kancelarie	75806	59058
Shpenzime blerje energji,avull,uje	572625	548980
Nenkontraktor	101848280	38115040
	139223878	79364275

Totali i shpenzimeve të tjera

Në shpenzimet për mirëmbajtja e riparime përfshihen shpenzimet e bëra për riparimin e makinerive të prodhimit, të mjeteve të transportit të shpërndarjes, të ndërtesës së magazinës, të sistemit informatik, etj.

Shpenzimet e siguracionit paraqesin shpenzimet për sigurimin e pronës dhe automjeteve.

Shpenzimet e ndryshme paraqesin shpenzimet e ndryshme te kryera per aktivitetin, rezultatin nga shitja e aktiveve afatgjata, diferencat e konvertimit te klienteve dhe furnitoreve ne fund te vitit, etj.

Nga perkthimi i klienteve dhe furnitorëve në fund të vitit ka rezultuar një humbje 21275 lekë.

Shpenzimet për shërbime profesionale paraqesin shpenzimet e ndryshme për noterinë, konsulencën ligjore, ekonomike, etj.

Shpenzimet e karburantit paraqesin vleftën e karburantit të konsumuar për mjetet e shpërndarjes dhe furnizimit,gjenerator,etj.

Shpenzimet e marketingut dhe promocionale paraaesin shumen e shpenzimeve te bera per pjsemarrje ne panair, per promocione, per marketingun, per katalogje, etj te ngjashme

Shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujë, paraqesin vleftën e energjisë elektrike dhe ujit të konsumuar në kapanonin për prodhimin dhe administrimin.

12.6.a) Shpenzime për tatime e taksa

Ne shpenzimet për tatime e taksa e te ngjashme janë përfshirë pagesat si ne tabelën e mëposhtme:

Shpenzime tatime e taksa	Viti 2019		Viti 2018	
	Në lekë	Në lekë	Në lekë	Në lekë
Taksa Vendore	866335		946819	
Shpenzime Kolaudime Automjete	136847		157568	
Taksa Qarkullimi Automjete				
Leje Transporti Automjete				
Taksa Ministria e Mjedisit				
Totali	1003182		1104387	

12.6.b) Shpenzime pritje-përcjellje, Gjoba, Penalitete, e të ngjashme

Ne këtë zë janë përfshirë shpenzimet që pasqyrohen ne tabelën e mëposhtme:

Shpenzime pritje, gjoba, penalitete dëmshpërblime	Viti 2019	Viti 2018

	Në lekë	Në lekë
Gjoba të tjera të paguara	1363	30695
Shpenzime pritje, dhurata	565027	498742
Shpenzime të panjohura mirembajte e riparime	38903	227011
Shpenzime nga vitet e kaluara		6352058
Shpenzime te panjohura reparti		
Shpenzime te tjera te panjohura	28614	74895
Totali	633907	7183401

12.6.c) Mallra të dëmtuara e të skaduara

Në këtë zë paraqitet vlesta e skarcove të rezultura gjatë procesit të prodhimit të produkteve të gatshme dhe gjatë ruajtjes së tyre.

12.6 d) Vlera Kontabël e AAM të nxjerra e të shitura

Në këtë zë të Shpenzimeve për vitin 2019 paraqitet vlera kontabël e AAM-ve të shitura gjatë vitit.

12.7 Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat

Përbërja e këtij zëri të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve paraqitet si vijon:

12.7 Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat

Në zërin të Ardhura dhe Shpenzime për interesa janë përfshirë diferençat ndërmjet të Ardhurave dhe Shpenzimeve për interesat. Paraqitja si vijon:

Të ardhura dhe shpenzime nga interesat	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Shpenzime për interesat e huave bankare	3850935	4242795
Të ardhura ngaa interesat bankare	172010	838
Totali	3678925	4241957

12.8 Fitimet dhe humbjet nga këmbimi

Paraqesin fitimet dhe humbjet e vërtetuarë gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditeteve të shprehura ne monedha te huaja. Paraqitja e tyre jepet ne tabelën vijuese:

Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi i MM	Viti 2019	Viti 2018
	Në lekë	Në lekë
Humbje nga këmbimi		
Humbje nga përkthimi i Mjeteve monetare fund viti.	16195	371691
Fitime nga përkthimi në fund të vitit i mjeteve monetare	169166	1297293
Totali	152971	925602

Diferencat nga kurset e këmbimit të mjeteve monetare dhe të éprikthimit të detyrimeve dhe të drejtave të shprehur në monedhe të huaj, në mënyrë të përbledhur paraqiten si vijon:

	Viti 2019	Viti 2018
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit në total		
Rezultati neto nga përkthimet valutore i të drejtave dhe detyrimeve		
Rezultati neto nga përkthimi Mjeteve Monetare		
Rezultat neto i veprimeve nga këmbimi	152971	925602

12.9 Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare

Në këtë zë të pasqyrës së të ardhurave paraqiten elementët si vijon:

Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	Viti 2019 Në lekë	Viti 2018 Në lekë
Shpenzime te Tjera Financiare Te Ardhura te tjera	172010	838
Totali	172010	838

13. Tatimi aktual

Shoqëria ka rezultuar me një fitim neto kontabël para tatimit prej 17,250,025 lekë dhe me një fitim neto pas tatimit prej 14,521,862 leke. Për llogaritjen e rezultatit tatimor te vitit 2019 shoqëria ka bërë rregullimet e nevojshme fiskale, duke konsideruar si te panjohura për qëllime fiskale një sere shpenzimesh. Fitimi i tatushëm i shoqërisë për vitin 2019, pas rregullimeve me shpenzimet e panjohura për qëllime tatimore rezulton 18,187,751lekë.

Shoqëria, duke zbatuar kërkasat e ligjit "Për tatimin mbi te ardhurat" ka llogaritur si shpenzime te panjohura, për efekte tatimore për këtë periudhe një shume prej 937,726leke. Llogaritja e shpenzimeve të panjohura, dhe e rezultatit fiskal për gjithë vitin 2019 paraqiten si në tabelën vijuese:

	Viti 2019	Viti 2018
Fitimi /Humbja e vitit		
SHPENZIME TE PAZBRITSHME		
Gjoba të tjera të paguara	1364	6352058
Shpenzime Promocionale e Marketingu	38903	277011
Shpenzime të panjohura mirembajte e riparime	639144	
Interesa per hua te dhene		
Shpenzime te panjohura për automjetet	897459	74895
Shpenzime te ndryshme te panjohura		
Rezultati fiskal i vitit 2019	1576870	6653964

Humbja fiskale e mbartur nga vitet e mëparshme

Fitimi fiskal për vitin 2019

Tatimi mbi fitimin me tarifën 15%

Rezultati neto i bilancit

18,826,895

-2,824034

14,425,991

14. Transaksione me Palët e lidhura

Gjatë vitit nuk ka transaksione me pale te lidhura. Tepricat e marredhenieve me palet e lidhura vijne nga vitet paraardhese. Një paraëqitje e transaksioneve dhe tepricave të tyre ne fund jepet si me poshtë:

Tepricat ne bilanc 31.12.2019

	Viti 2019 Në lekë	Viti 2018 Në lekë
Te tjera (Financim nga ortaku)	3,000,000	3,000,000
Totali	3,000,000	3,000,000

15. Ngjarjet mbas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.

ADMINISTRATOR

RESILDA KALIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME



ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

816521

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. DURRËS
Numri i Pasurisë 10/268 Zona Kadastrale Nr. 8516
Adresa e Pasurisë durres Rruga shkozet Volumi 18 Faqe 75
Lloji i Pasurisë GODINE
Sipërfaqja Totale 293.36 Nga kjo : Sa Ndërtesa 293.36
Nga kjo : Sa Truall %
Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotérinjtë)

Emri Atnësia Mbiemri Pjesa Adresa
"LIQENI VII" SH.A. DURRES 1/1 durres Rruga shkozet

pasurisë me numër 10/268

- është pronar i pasurisë me numër 10/268
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme.

Data e lëshimit të çertifikatës
20/3/2014

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së
paraqitur nga i (të) interesuar (t)
më datë 18/2/2014 Nr. 2513


Lëshuesi / Çertifikates
REGISTRUESI
JURGIS CYRBJA

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME

DURRES

REGJISTRUESI IRRETHIT



A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 8516 NR.PASURISE 10/268 Vol. 18 FQ 75
INDEKSI I HARTES DR - H-II SHKALLA 1:500 SIP = 293,36m²
ADRESA E PASURISE: Rrjeti Durrës Qif DURRES
Rr/L SHKOZET P/G Sh K Ap

C. PRONARI

B. KUFIZIME

V. PASURIA Nr. 10/265
L. PASURIA Nr. 10/265
J. PASURIA Nr. 10/265
P. PASURIA Nr. 10/261

D. Data 10/03/2014 Ora 13⁰⁰

ZIORTI VII DURRES
SH.A.

Mir GORAU

151



V E R T E T I M

Une Znj.Leze Abazi Auditues Ligjor(Eksperte Kontabel e Regjistruar) jam angazhuar per te audituar Pasqyrat Financiare te vitit 2019 te Shoqerise "Liqeni VII" Sh.a, Durres.

Procesi I auditimit nuk mund te perfundoj brenda dates 31.03.2019, pra nuk mund te leshojme nje raport auditimit Brenda kesaj date.

Raporti I auditimit do te leshohet nga ne, ne momentin e perfundimit te procesit te auditimit.

E leshoj kete vertetim me kerkese te Shoqerise "Liqeni VII" Sh.a Durres, per te konfirmuar qe shoqeria eshte ne process auditimi.

Date, 21.03.2020

Leze ABAZI

Auditues Ligjor(EKR)

